

ARTICLES OF ASSOCIATION

OF THE LIMITED LIABILITY COMPANY

“Ewopharma Albania” SHPK

OWNERSHIP, SCOPE OF ACTIVITY, REGISTERED OFFICE

Article 1 Sole Shareholder

1.1 The company **“Ewopharma Albania” SHPK** (the **“Company”**) is established on the date hereof by the following Sole Shareholder:

Ewopharma AG, a company incorporated and existing under the laws of Switzerland, with business identification number CHE-1 07.428.351, having its registered seat at Vordergasse 43, 8200 Schaffhausen, Switzerland (hereinafter referred to as the **“Sole Shareholder”**).

Article 2 Name

2.1 The name of the Company is **“Ewopharma Albania” SHPK**.

2.2 In all the documents, invoices, advertisements and publications issued by the Company, regardless of the means for transmission, the name of the Company should be preceded or followed by the following:

- i. the words *“Shoqëri me përgjegjësi të kufizuar”* or *“SHPK”*;
- ii. its unique identification number (NUIS);
- iii. the registered capital and the paid in capital of the Company;
- iv. the address of its registered seat; and
- v. a note that the Company is under liquidation, if applicable.

Article 3 Legal form

3.1 The Company is established and organized as a limited liability company in accordance with law no. 9901, dated 14.04.2008 “On entrepreneurs and

STATUT

I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR

“Ewopharma Albania” SHPK

PRONËSIA, OBJEKTI, SELIA

Neni 1 Ortaku i Vetëm

1.1 Shoqëria **“Ewopharma Albania” SHPK** (**“Shoqëria”**) është themeluar në datën e dhënë në këtë Statut nga Ortaku i Vetëm si më poshtë:

Ewopharma AG një shoqëri e themeluar dhe që ekziston sipas ligjeve të Zvicrës, me numër regjistrimi biznesi CHE-1 07.428.351, me seli të regjistruar në adresën Vordergasse 43, 8200 Schaffhausen, Zvicër (në vijim referuar si **“Ortaku i Vetëm”**).

Neni 2 Emri

2.1 Emri i Shoqërisë është **“Ewopharma Albania” SHPK**.

2.2 Në të gjitha dokumentet, faturat, reklamat dhe botimet e lëshuara nga Shoqëria, pavarësisht nga mënyra për transmetim, emri i Shoqërisë duhet të paraprihet ose pasohet nga sa vijon:

- i. fjalët *“Shoqëri me përgjegjësi të kufizuar”* ose *“SHPK”*;
- ii. numri unik i identifikimit (NUIS);
- iii. kapitali themeltar dhe kapitali i paguar i Shoqërisë
- iv. adresa e selisë; dhe
- v. një shënim që Shoqëria është në likuidim, nëse e zbatueshme.

Neni 3 Forma ligjore

3.1 Shoqëria është themeluar dhe organizuar si një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar në përputhje me ligjin nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për sipërmarrësit

<p>commercial companies”, as amended (the “Company Law”).</p> <p>3.2 The Company may be transformed into another legal form in compliance with the Albanian legislation.</p>	<p>dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar (“Ligji për Shoqëritë Tregtare”).</p> <p>3.2 Shoqëria mund të shndërrohet në një formë tjetër ligjore në përputhje me legjislacionin shqiptar.</p>
<p style="text-align: center;">Article 4 Legal grounds</p>	<p style="text-align: center;">Neni 4 Bazat Ligjore</p>
<p>4.1 The Company will carry out its activity in compliance with these Articles of Association, the Company Law and other applicable provisions of the Albanian law.</p>	<p>4.1 Shoqëria do të kryejë veprimtarinë e saj në përputhje me këtë Statut, Ligjin për Shoqëritë Tregtare dhe dispozitat e tjera të zbatueshme të ligjit shqiptar.</p>
<p style="text-align: center;">Article 5 Duration of activity</p>	<p style="text-align: center;">Neni 5 Kohëzgjatja e aktivitetit</p>
<p>5.1 The duration of the Company is unlimited.</p>	<p>5.1 Kohëzgjatja e Shoqërisë është pa afat.</p>
<p style="text-align: center;">Article 6 Seat / Registered office</p>	<p style="text-align: center;">Neni 6 Selia</p>
<p>6.1 The registered office of the Company is at Str. Reshit Collaku, Pallati Classic Construction, H.2, 2nd floor, no. 12, Administrative Unit no. 10, Tirana, Albania.</p>	<p>6.1 Selia e Shoqërisë është në Rr. Reshit Collaku, Pallati Classic Construction, H.2, Kati 2, nr. 12, Njësia Administrative nr. 10, Tiranë, Shqipëri.</p>
<p>6.2 The Administrator may establish or close in Albania secondary addresses of the Company.</p>	<p>6.2 Administratori mund të hapë ose të mbyllë në Shqipëri adresat dytësore të Shoqërisë.</p>
<p>6.3 The Sole Shareholder may establish or close agencies, representative offices, branches not having the character of secondary addresses, as well decide upon any change of the registered office.</p>	<p>6.3 Ortaku i Vetëm mund të hapë ose mbyllë agjenci, zyra përfaqësuese, degë që nuk kanë karakterin e adresave dytësore, si dhe të vendosë për çdo ndryshim të selisë.</p>
<p style="text-align: center;">Article 7 Object</p>	<p style="text-align: center;">Neni 7 Objekti</p>
<p>7.1 The Company will operate any lawful activity related to the import, wholesale and/or retail sale, marketing, advertising and promotion of pharmaceutical products and any additional activities allowed or conducted in compliance with applicable laws and regulations in the Republic of Albania.</p>	<p>7.1 Shoqëria do të kryejë çdo aktivitet të ligjshëm lidhur me importin, tregtimin me shumicë dhe/ose pakicë, marketingun, reklamimin dhe promovimin e produkteve farmaceutike dhe çdo aktiviteti shtesë të lejuar ose që kryhet në përputhje me ligjet e zbatueshme dhe rregulloret në Republikën e Shqipërisë.</p>
<p>7.2 The Company may carry out all the auxiliary or connected operations which may be considered useful or necessary in order to pursue the Company’s business purpose and object in accordance with the law.</p>	<p>7.2 Shoqëria mund të kryejë të gjitha veprimet ndihmëse ose të lidhura të cilat mund të konsiderohen të dobishme ose të nevojshme për të përmbushur qëllimin e biznesit dhe objektin e Shoqërisë në përputhje me ligjin.</p>

<p>7.3 The object of the Company may be amended by resolution of the Sole Shareholder.</p>	<p>7.3 Objekti i Shoqërisë mund të ndryshohet me vendim të Ortakut të Vetëm</p>
<p style="text-align: center;">Article 8 Capital</p>	<p style="text-align: center;">Neni 8 Kapitali</p>
<p>8.1 The registered capital of the Company on the date hereof is EUR 1,000 (one thousand Euro) and shall consist of 1 (<i>one</i>) share.</p>	<p>8.1 Kapitali themeltar i Shoqërisë në datën e këtij Statuti është EUR 1,000 (një mijë Euro) dhe do të përbëhet nga 1 (<i>një</i>) kuotë.</p>
<p>8.2 The Sole Shareholder holds 1 (one) share representing 100% of the share capital.</p>	<p>8.2 Ortaku i Vetëm zotëron 1 (një) kuotë që përfaqëson 100% të kapitalit.</p>
<p>8.3 The capital will be paid in monetary value via bank transfer in one or more instalments in the bank account of the Company opened with any bank in Albania within 1 (one) year starting from the registration of the Company.</p>	<p>8.3 Kapitali do të paguhet në vlerë monetare me anë të transfertës bankare në një ose më shumë këste në llogarinë bankare të Shoqërisë të hapur në çdo bankë në Shqipëri brenda 1 (një) viti duke filluar nga regjistrimi i Shoqërisë.</p>
<p style="text-align: center;">Article 9 Transfer of capital shares / Restrictions on transfer</p>	<p style="text-align: center;">Neni 9 Transferimi i kapitalit / Kufizimet në transferim</p>
<p>9.1 The Sole Shareholder is the exclusive owner of all shares of the registered capital of the Company.</p>	<p>9.1 Ortaku i Vetëm është pronari ekskluziv i të gjitha kuotave të kapitalit themeltar të Shoqërisë.</p>
<p>9.2 The shares of the registered capital may be transferred, in whole or in part, to third parties only by written deed.</p>	<p>9.2 Kuotat e kapitalit themeltar mund të transferohen, plotësisht ose pjesërisht, tek palët e treta vetëm me akt me shkrim.</p>
<p style="text-align: center;">Article 10 Capital increase</p>	<p style="text-align: center;">Neni 10 Zmadhimi i kapitalit</p>
<p>10.1 The Sole Shareholder may increase the share capital by increasing its contribution in the registered capital of such amount and under such terms as the resolution of the Sole Shareholder prescribes.</p>	<p>10.1 Ortaku i Vetëm mund të zmadhojë kapitalin duke zmadhuar kontributin e tij në kapitalin themeltar me atë shumë dhe sipas atyre kushteve që përcaktohen në vendimin e Ortakut të Vetëm.</p>
<p>10.2 The capital increase may also be made through subscription and paying-in of new capital shares by new shareholders. New shareholders shall be accepted and approved as such by resolution of the Sole Shareholder.</p>	<p>10.2 Zmadhimi i kapitalit mund të bëhet gjithashtu me anë të nënshkrimit dhe pagimit të kuotave të reja të kapitalit nga ortakët e rinj. Ortakët e rinj do të pranohen dhe miratohen si të tillë me vendim të Ortakut të Vetëm.</p>
<p style="text-align: center;">Article 11 Decrease of capital</p>	<p style="text-align: center;">Neni 11 Zvogëlimi i kapitalit</p>
<p>11.1 The share capital of the Company may be reduced by resolution of the Sole Shareholder in any way permitted by law.</p>	<p>11.1 Kapitali i Shoqërisë mund të zvogëlohet me vendim të Ortakut të Vetëm në çdo mënyrë të lejuar nga ligji.</p>

GOVERNANCE STRUCTURE	STRUKTURA E DREJTIMIT
Article 12 Sole Shareholder's Resolutions	Neni 12 Vendimet e Ortakut të Vetëm
<p>12.1 The main decisions of the Company's activity are taken by the Sole Shareholder which is the supreme body of the Company. The resolutions of the Sole Shareholder must be registered in a register of decisions the data of which may not be altered or erased.</p>	<p>12.1 Vendimet kryesore lidhur me aktivitetin e Shoqërisë merren nga Ortaku i Vetëm, i cili është organi më i lartë drejtues i Shoqërisë. Vendimet e Ortakut të Vetëm duhet të regjistrohen në një regjistër vendimesh, të dhënat e të cilit nuk mund të ndryshohen ose fshihen.</p>
<p>12.2 The meeting of general assembly can be convoked by any of the Administrator(s), or by the Sole Shareholder by registered post or electronic mail at least seven days in advance. As long as there is only one shareholder in the Company and if the Sole Shareholder so decides, the latter can waive the formalities for the convocation of the meeting and resolutions of the general assembly can be taken in a written form executed by the Sole Shareholder and no minutes are required to be taken. In case of urgent resolution of approval is required, an electronic prior approval (by e-mail) of the Sole Shareholder may precede the written decision of the Sole Shareholder, which shall be drafted later and registered with the register of decision of the Company.</p>	<p>12.2 Mbledhja e asamblesë së përgjithshme mund të thirret nga çdo Administrator, ose nga Ortaku i Vetëm me postë të regjistruar ose postë elektronike të paktën shtatë ditë përpara. Për sa kohë Shoqëria ka vetëm një ortak dhe nëse vendoset kështu nga Ortaku i Vetëm, ky i fundit mund të heqë dorë nga formalitetet për thirrjen e mbledhjes dhe vendimet e asamblesë së përgjithshme mund të merren në një formë të shkruar, nënshkruar nga Ortaku i Vetëm dhe nuk kërkohet të mbahet asnjë procesverbal. Në rast se kërkohet një vendim miratimi urgjent, miratimi paraprak elektronik (me e-mail) i Ortakut të Vetëm mund të paraprijë vendimin me shkrim të Ortakut të Vetëm, i cili hartohet më vonë dhe regjistrohet në regjistrin e vendimeve të Shoqërisë.</p>
<p>12.3 Only the Sole Shareholder shall be entitled to decide on the following matters:</p> <ol style="list-style-type: none"> a) determine the commercial policies of the Company; b) amendment of the Articles of Association; c) acceptance of new shareholders (after an increase in the registered capital or a transfer of shares); d) increase and/or decrease the registered capital; e) resolve on a merger, spin-off, dissolution and any kind of transformation of the Company; f) establish and/or close down branches and representation offices; g) subscription and acquisition of shares in other entities or transfer or creation of any encumbrance or any other charge over any shares held by the Company in any other entities; h) supervise the implementation of the commercial policies by the administrator(s) and or any other body of the Company; 	<p>12.3 Vetëm Ortaku i Vetëm ka të drejtë të vendosë lidhur me çështjet e mëposhtme:</p> <ol style="list-style-type: none"> a) përcakton politikat tregtare të Shoqërisë; b) ndryshimi i Statutit; c) pranimi i ortakëve të rinj (pas zmadhimit të kapitalit të regjistruar ose transferimit të kuotave); d) zmadhimi dhe/ose zvogëlimi i kapitalit të regjistruar; e) vendos për bashkimin, ndarjen, prishjen dhe çdo lloj transformimi të Shoqërisë; f) themelon dhe/ose mbyll degët dhe zyrat e përfaqësimit; g) nënshkrimi dhe blerja e kuotave në subjekte të tjera apo transferimi ose krijimi i ndonjë barre ose ndonjë detyrimi tjetër mbi kuotat e mbajtura nga Shoqëria në ndonjë subjekt tjetër; h) mbikëqyr zbatimin e politikave tregtare nga administratori(ët) dhe ose ndonjë organ tjetër i Shoqërisë;

- i) approve the annual financial statements and balance sheet, the business plan and approve the distribution of profit and/or coverage of losses;
- j) appoint and dismiss the administrator(s) and appoint the representative authorized to sign the employment or service agreement with the administrator(s);
- k) employment and dismissal of top managers and any determination or amendment of their functions, powers and delegations of powers and their salaries, remuneration and benefits;
- l) resolve on the internal rules, measures, policies and procedures for the management and supervision;
- m) commencing, compromising, settling, waiving of a right in relation to a material litigation or arbitration proceedings for a value of more than EUR 25,000 or its equivalent in any other currency according to the official exchange rate of National Bank of Albania applicable at the date of the respective action;
- n) file suits against the administrator(s) of the Company;
- o) resolve on the acquisition, sale and encumbrance of immovable property;
- p) determine the remuneration of the administrator(s);
- q) resolve on the appointment of auditors;
- r) approve the management and administrative organisation of the Company;
- s) incurring any costs/expenditures and/or conclusion of any agreement and/or any kind of transaction exceeding EUR 50,000 or its equivalent in other currency, on an annual basis, as a single act(ion) or as a series of related act(ion)s or payments to the same natural person or legal entity within the same calendar year;
- t) applying for borrowings, financings and/or issuance or placing of securities, guarantees or collaterals;
- u) approve the conclusion of agreements that are under a conflict-of-interest situation in accordance with article 13 of the Company Law;

- i) miraton pasqyrat vjetore financiare dhe bilancin, planin tregtar dhe miraton shpërndarjen e fitimit dhe/ose mbulimin e humbjeve;
- j) emëron dhe shkarkon administratorin(t) dhe emëron përfaqësuesin e autorizuar për të nënshkruar kontratën e punës ose shërbimit me administratorin(ët);
- k) punësimi dhe shkarkimi i drejtuesve të lartë dhe çdo përcaktim ose ndryshim i funksioneve të tyre, kompetencave dhe delegimeve të kompetencave dhe pagave, shpërblimeve dhe përfitimeve të tyre;
- l) vendosja e rregullave të brendshme, masave, politikave dhe procedurave për drejtimin dhe mbikëqyrjen;
- m) fillimi, kompromisi, zgjidhja me mirëkuptim, heqja dorë nga një e drejtë në lidhje me një çështje gjyqësore materiale ose procedurë arbitrazhi për një vlerë prej më shumë se 25,000 euro ose ekuivalente me të në ndonjë monedhë tjetër sipas kursit zyrtar të këmbimit të Bankës Kombëtare të Shqipërisë të zbatueshme në datën e veprimit përkatës;
- n) ngritja e padive kundër administratorit(ëve) të Shoqërisë;
- o) vendimi për blerjen, shitjen dhe hipotekimin e pasurisë së paluajtshme;
- p) përcakton shpërblimin e administratorit(ëve);
- q) vendos për emërimin e audituesve;
- r) miraton menaxhimin dhe organizimin administrativ të Shoqërisë;
- s) kryerja e çdo kostoje/shpenzimi dhe/ose lidhja e çdo marrëveshje dhe/ose çdo lloj transaksioni që tejkalon 50,000 euro ose ekuivalente në një monedhë tjetër, si një akt/veprim i vetëm ose si një sërë aktesh/veprimesh të lidhura ose pagesa për të njëjtin person fizik ose person juridik brenda të njëjtin vit kalendarik;
- t) aplikimi për huamarrje, financime dhe/ose emetime ose vendosje të letrave me vlerë, garancive ose kolateraleve;
- u) miratimi i lidhjes së marrëveshjeve që janë në një situatë me konflikt interesi sipas nenit 13 të Ligjit për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare;

- v) decide on any other matters which has been reserved to the shareholder by the Company Law and/or these Articles of Association.

**Article 13
Administrator**

- 13.1. The Company's daily administration shall be assigned to one or more administrator(s) ("Administrator") nominated and replaced by the Sole Shareholder. The director of a parent company may not be appointed as Administrator of a subsidiary and vice versa.
- 13.2. Administrators need not be shareholders and may be re-elected.
- 13.3. The Administrator is entitled to the ordinary and daily management of the Company and shall adopt all decisions that it may deem fit to achieve and implement the corporate object, as well as shall individually represent the Company during its daily and ordinary business, except for actions or matters reserved to or to be completed jointly with another person or body in accordance with these Articles of Association or resolutions of the Sole Shareholder adopted from time to time.
- 13.4. Unless a matter is reserved to the Sole Shareholder under the Company Law or requires the prior approval of the Sole Shareholder in accordance with article 12.3 of these Articles of Association or in accordance with resolutions of the Sole Shareholder adopted from time to time, any of the Administrators shall be individually empowered to the following actions:
- a. Manage the day-to-day business of the Company in compliance with resolutions and instructions of the Sole Shareholder.
 - b. Represent the Company vis-à-vis third parties and public authorities.
 - c. Open, operate and close bank accounts of the Company.
 - d. Conclude agreements and transactions with third parties.
 - e. Issue invoices, request or perform payments and accept securities from third parties.
 - f. Hire and dismiss Company's staff and determine their salaries, benefits and other remunerations.

- v) vendosja për çdo çështje tjetër për të cilat ortakut ka të drejtë sipas Ligjit për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare dhe/ose këtij Statuti.

**Neni 13
Administratori**

- 13.1 Administrimi i përditshëm i Shoqërisë do t'i caktohet një ose më shumë administratorëve ("Administratori") të emëruar dhe zëvendësuar nga Ortaku i Vetëm. Drejtori i një shoqërie mëmë nuk mund të emërohet si Administrator i një filiali dhe anasjelltas.
- 13.2 Nuk është e nevojshme që Administratorët të jenë ortakë dhe ata mund të rizgjidhen.
- 13.3 Administratori ka të drejtën e administrimit të zakonshëm dhe të përditshëm të Shoqërisë dhe do të miratojë të gjitha vendimet që ai mund t'i konsiderojë të përshtatshme për të arritur dhe zbatuar objektin e shoqërisë, si dhe do të përfaqësojë individualisht Shoqërinë gjatë veprimtarisë të saj tregtare të përditshme dhe të zakonshme, përveç veprimeve ose çështjeve të rezervuara ose për tu kryer bashkërisht me një person ose organ tjetër në përputhje me këtë Statut ose vendimet e Ortakut të Vetëm të miratuara kohë pas kohe.
- 13.4 Përveçse kur një çështje i rezervohet Ortakut të Vetëm sipas Ligjit për Shoqëritë Tregtare ose kërkon miratimin paraprak të Ortakut të vetëm në përputhje me nenin 12.3 të këtij Statuti ose në përputhje me vendimet e Ortakut të Vetëm të miratuara kohë pas kohe, secili nga Administratorët do të ketë kompetenca individuale për veprimet e mëposhtme:
- a. Të administrojë biznesin e përditshëm të Shoqërisë në përputhje me vendimet dhe udhëzimet e Ortakut të Vetëm.
 - b. Të përfaqësojë Shoqërinë kundrejt palëve të treta dhe autoriteteve publike.
 - c. Të hapë, operojë dhe mbyllë llogaritë bankare të Shoqërisë.
 - d. Të lidhë marrëveshje dhe kryejë transaksione me palë të treta;
 - e. Të lëshojë fatura, kërkojë ose kryejë pagesa dhe pranojë letra me vlerë nga palët e treta;
 - f. Të punësojë dhe shkarkojë stafin e Shoqërisë dhe përcaktojë pagat, përfitimet dhe shpërblimet e tyre;

<p>g. Keep accounting books as prescribed by the law and accounting principles.</p> <p>h. Prepare the annual financial statements of the Company and cause their audit by external auditors if required by the law or by resolution of the Sole Shareholder.</p> <p>i. Perform other actions related to the ordinary business of the Company.</p>	<p>g. Të mbajë librat e kontabilitetit siç përcaktohet nga ligji dhe parimet e kontabilitetit;</p> <p>h. Të përgatisë pasqyrat financiare vjetore të Shoqërisë dhe të kryejë auditimin e tyre nga auditues të jashtëm nëse kërkohet nga ligji ose me vendim të Ortakut të Vetëm;</p> <p>i. Të kryejë veprime të tjera në lidhje me veprimtarinë e zakonshme tregtare të Shoqërisë.</p>
<p>13.5. The limitations provided under article 12.3 of these Articles of Association shall be registered with the National Business Centre and any action performed by the Administrator with third parties shall be binding on the Company only with the prior approval of the Sole Shareholder. For the avoidance of doubt, actions with third parties provided in letters g), k) m), o), s), t) and u) of article 12.3 of these Articles of Association can be performed by the Administrator only with the prior approval of the Sole Shareholder and should be registered as limitations of the powers of the Administrator. Amendment of the management and representation powers of the Administrator or any limitation thereof can be set by resolution of the Sole Shareholder adopted from time to time. Any amendment of the management and representation powers or any limitation thereof by resolution of the Sole Shareholder shall not be construed as an amendment of these Articles of Association.</p>	<p>13.5 Kufizimet e parashikuara në nenin 12.3 të këtij Statuti do të regjistrohen në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe çdo veprim i kryer nga Administratori me palë të treta do të jetë i detyrueshëm për Shoqërinë vetëm me miratimin paraprak të Ortakut të Vetëm. Për të shmangur dyshimin, veprimet me palët e treta të parashikuara në gërmat g), k) m), o), s), t) dhe u) të nenit 12.3 të këtij Statuti mund të kryhen vetëm nga Administratori me miratimin paraprak të Ortakut të Vetëm dhe duhet të regjistrohen si kufizime të kompetencave të Administratorit. Çdo ndryshim i kompetencave të administrimit dhe përfaqësimit të Administratorit ose ndonjë kufizim i tyre mund të kryhet me vendim të Ortakut të Vetëm të miratuar kohë pas kohe. Çdo ndryshim i kompetencave të administrimit dhe përfaqësimit ose ndonjë kufizim i tyre me vendim të Ortakut të Vetëm nuk do të interpretohet si një ndryshim i këtij Statuti.</p>
<p>13.6. The Administrator can, delegate partially his rights to a third person by authorization sealed with the Company's seal (a special power-of-attorney).</p>	<p>13.6 Administratori mund, të delegojë pjesërisht të drejtat e tij tek një palë e tretë me autorizim të vulosur me vulën e Shoqërisë (autorizim i posaçëm).</p>
<p>13.7. The prior approval of the Sole Shareholder can be granted by resolution (notifiable also by email) or by countersignature of the representative of the Sole Shareholder or any other person appointed by him.</p>	<p>13.7 Miratimi paraprak i Ortakut të Vetëm mund të jepet me vendim (që mund të njoftohet edhe me email) ose me kundërnënshkrim të përfaqësuesit të Ortakut të Vetëm ose të ndonjë personi tjetër të caktuar nga ai.</p>
<p>13.8. The Administrator shall hold office for a period not exceeding 5 (five) years as determined in the appointment resolution, his mandate being renewable, unless revoked and replaced earlier for any cause by resolution of the Sole Shareholder. The revocation of the Administrator by resolution of the Sole Shareholder shall not be construed as an automatic termination of its contract by the Company, the respective contractual notices, time</p>	<p>13.8 Administratori do të ketë mandat për një periudhë që nuk i kalon 5 (pesë) vjet siç do përcaktohet në vendimin e emërimit, me mandat të rinovueshëm, përveç nëse revokohet dhe zëvendësohet më herët për çdo shkak me vendim të Ortakut të Vetëm. Revokimi i Administratorit me vendim të Ortakut të Vetëm nuk do të interpretohet si një zgjidhje automatike e kontratës së tij nga Shoqëria, njoftimet përkatëse të kontratës, afatet</p>

<p>limits and remunerations provided in these contracts, if any, should be observed and constitute just and full remuneration for any claim of the Administrator.</p> <p>13.9. The Administrator shall report to the Sole Shareholder.</p> <p>13.10. The first Administrators of the Company appointed for a term of 2 (two) years are:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Mr. Mentor Latifi, Kosovan citizen, born on 25.10.1974, in Prishtina; and - Mr. Miran Rojec, Slovenian citizen, born on 10.10.1967, in Ljubljana. 	<p>kohore dhe shpërblimet e parashikuara në këto kontrata, nëse ka, duhet të respektohen dhe të përbëjnë shpërblim të drejtë dhe të plotë për çdo pretendim të Administratorit.</p> <p>13.9 Administratori do t'i raportojë Ortakut të Vetëm.</p> <p>13.10 Administratorët e parë të Shoqërisë të emëruar për një periudhë 2 (dy) vjeçare janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Z. Mentor Latifi, shtetas kosovar, i lindur më 25.10.1974, në Prishtinë; and - Z. Miran Rojec, shtetas Slloven, i lindur më 10.10.1967, në Ljubljanë.
<p>Article 14 Fiduciary Duties and Liability</p>	<p>Neni 14 Detyrat dhe Përgjegjësia e Administratorit</p>
<p>14.1 In addition to general fiduciary duties laid down in Article 13, 14, 15, 17 and 18 of the Company Law, the Administrator(s) must:</p> <ol style="list-style-type: none"> a. perform their duties under the Company Law, these Articles of Association or set out by resolutions of the Sole Shareholder in good faith and in the best interest of the Company as whole, paying particular attention to the impact of its operation on the environment; b. exercise their powers granted to them by the Company Law, these Articles of Association or set out by resolutions of the Sole Shareholder, only for the purposes established therein; c. give adequate consideration to the matters to be decided; d. prevent and avoid actual and potential conflicts between personal interests and those of the Company; e. exercise due diligence and care of a reliable and conscientious businessperson and shall observe secrecy with regard to confidential matters; f. provide any information regarding business and economic data requested by the Sole Shareholder within reasonable time and in any case not later than 7 (seven) days. Information and data must be up to date. 	<p>14.1 Përveç detyrave të përcaktuara në Nenet 13, 14, 15, 17 dhe 18 të Ligjit për Shoqëritë Tregtare, Administratori(ët) duhet:</p> <ol style="list-style-type: none"> a. të përmbushin detyrat e tyre sipas Ligjit për Shoqëritë Tregtare, këtij Statuti ose të përcaktuara me vendim të Ortakut të Vetëm në mirëbesim dhe në interesin më të mirë të Shoqërisë në tërësi, duke i kushtuar vëmendje të veçantë ndikimit në mjedis të veprimtarisë të saj; b. të ushtrojnë kompetencat e tyre të parashikuara në Ligjin për Shoqëritë Tregtare, këtë Statut ose të përcaktuara me vendim të Ortakut të Vetëm, vetëm për qëllimet e përcaktuara këtu; c. të marrin në konsideratë çështjet që do të vendosen; d. të parandalojnë dhe të shmangin konfliktet aktuale dhe të mundshme midis interesave personale dhe atyre të Shoqërisë; e. të kenë kujdesin e duhur që karakterizon një tregtar të besueshëm dhe të ndërgjegjshëm dhe të respektojnë fshehtësinë në lidhje me çështjet konfidenciale; f. të sigurojnë çdo informacion në lidhje me të dhënat e biznesit dhe ato ekonomike të kërkuara nga Ortaku i Vetëm brenda një kohe të arsyeshme dhe në çdo rast jo më vonë se 7 ditë. Informacioni dhe të dhënat duhet të përditësohen.
<p>14.2 The Administrator(s) shall, in the performance of their duties, be held liable to the Company for an act</p>	<p>14.2 Administratori(ët), gjatë përmbushjes së detyrave të tyre, do të jenë përgjegjës ndaj Shoqërisë për një</p>

or omission which is rationally related to the object of the Company, unless, pursuant to an inquiry and evaluation of the relevant information, the act or omission was done in good faith.

14.3 In case of violation of duties and standards of due diligence referred to in paragraphs 1 and 2 of the present Article 14, the Administrator shall have a duty to compensate the Company for any damages resulting from the violation. He/she shall also disgorge any personal gains obtained by him or related persons during the violation of his duties. He/she shall have the burden of proving the compliance with his duties and the required standards. Where a violation has been committed by more than one person, all persons in question shall be jointly and severally liable to the Company.

14.4 In particular, but not exclusively, Administrators shall be obliged to compensate the Company for the damage, if they carry out contrary to the Company Law, these Articles of Association or resolutions of the Sole Shareholder the following transactions:

- a. return contributions;
- b. pay interest or dividends;
- c. distribute the company's assets;
- d. let the company to do business when, according to its financial situation, it is foreseeable that it would be unable to pay its debts;
- e. grant loans.

14.5 Article 92, paragraph 6 of the Company Law shall also be applicable to claims under the preceding paragraphs of the present article. These claims must be submitted within 3 years of the commitment of the violation or its discovery.

Article 15
Chartered accountant(s)

15.1 If necessary, an external auditor of the Company shall be appointed by resolution of the Sole Shareholder. The mandate of the auditor, if appointed, must be renewed annually.

veprim ose mosveprim që lidhet në mënyrë të arsyeshme me objektin e Shoqërisë, përveç nëse, në vijim të hetimi dhe vlerësimit të informacionit përkatës, veprimi ose mosveprimi është kryer me mirëbesim.

14.3 Në rastin e shkeljes së detyrave dhe standardeve të kujdesit të duhur të referuar në paragrafët 1 dhe 2 të Nenit 14, Administratori është i detyruar të kompensojë Shoqërinë për çdo dëm që rrjedh nga kjo shkelje. Gjithashtu, ai do të heqë dorë nga përfitimet personale të marra nga ai ose persona të lidhur gjatë shkeljes së detyrave të tij. Ai do të ketë barrën e provës së pajtueshmërisë me detyrat e tij dhe standardet e kërkuara. Kur një shkelje është kryer nga më shumë se një person, të gjithë personat në fjalë do të jenë përgjegjës bashkërisht dhe veçmas ndaj Shoqërisë.

14.4 Në veçanti, por jo vetëm, Administratorët janë të detyruar të kompensojnë Shoqërinë për dëmin e shkaktuar, nëse ata kryejnë në kundërshtim me Ligjin për Shoqëritë Tregtare, këtë Statut ose vendimet e Ortakut të Vetëm, transaksionet e mëposhtme:

- a. kthejnë kontributet;
- b. paguajnë interesat ose dividendët;
- c. shpërndajnë aktivet e Shoqërisë;
- d. lejojnë shoqërinë që të kryejë veprimtari tregtare kur, sipas situatës së saj financiare, është parashikuar që ajo nuk do të jetë në gjendje të paguajë borxhet e saj;
- e. japin hua.

14.5 Neni 92, paragrafi 6 i Ligjit për Shoqëritë Tregtare do të jetë gjithashtu i zbatueshëm për pretendimet sipas paragrafëve të mësipërm të këtij neni. Këto pretendime duhet të paraqiten brenda 3 viteve nga kryerja e shkeljes ose zbulimi i saj.

Neni 15
Audituesi(ët) ligjor

15.1 Audituesi i jashtëm i Shoqërisë do të emërohet me vendim të ortakut të Vetëm nëse është e nevojshme. Mandati i audituesit, në rast se do të emërohet një i tillë, duhet të rinovohet çdo vit.

<p style="text-align: center;">Article 16 Financial year</p> <p>16.1 The financial year of the Company activity coincides with the calendar year, beginning as of 1st January and ending on 31 December of each year.</p>	<p style="text-align: center;">Neni 16 Viti financiar</p> <p>16.1 Viti financiar i aktivitetit të Shoqërisë përkon me vitin kalendarik, pra fillon më 1 janar dhe përfundon më 31 dhjetor të çdo viti.</p>
<p style="text-align: center;">Article 17 Financial Statements. Accounting</p> <p>17.1 Financial statements of the Company should be prepared to be submitted to tax authorities before the end of March of the consecutive year. The resolution of the Sole Shareholder approving the financial statements and deciding on the destination of the results shall be approved in accordance with the applicable laws.</p> <p>17.2 Accounting books should be kept in Albanian language and local currency (ALL). The Company may keep separate accounts in foreign currency, which amounts need to be converted, every month in local currency.</p>	<p style="text-align: center;">Neni 17 Pasqyrat Financiare. Kontabiliteti</p> <p>17.1 Pasqyrat financiare të Shoqërisë do të dorëzohen pranë autoriteteve tatimore para fundit të muajit mars të vitit pasardhës. Vendimi i Ortakut të Vetëm që miraton pasqyrat financiare dhe që vendos mbi destinimin e rezultatit do të miratohet në përputhje me ligjet e zbatueshme.</p> <p>17.2. Librat e kontabilitetit duhet të mbahen në gjuhën shqipe dhe monedhën vendase (Lekë). Shoqëria mund të mbajë llogari të tjera në valutë të huaj, shuma të cilave duhet të konvertohen në monedhën vendase çdo muaj.</p>
<p style="text-align: center;">Article 18 Liquidation</p> <p>18.1 The Sole Shareholder pursuant to the Company Law may resolve to dissolve the Company and appoint a liquidator or a group of liquidators that will handle the liquidation procedures.</p> <p>18.2 The liquidator(s) will prepare the liquidation report which contains an overall of economic standing of the Company, the steps of liquidation and the time needed for its completion. At the end of this process, the Sole Shareholder shall examine the final balance sheet and other liquidation documents and shall approve the termination of the liquidation procedure.</p>	<p style="text-align: center;">Neni 18 Likuidimi</p> <p>18.1 Ortaku i Vetëm, mbi bazën e Ligjit për Shoqëritë Tregtare, mund të vendosë të prishë Shoqërinë dhe të caktojë një likuidues ose një grup likuiduesish që do të merren me procedurat e likuidimit.</p> <p>18.2 Likuiduesi(ët) do të përgatisin raportin e likuidimit i cili përmban një përmbledhje të gjendjes ekonomike të Shoqërisë, hapat e likuidimit dhe kohën e nevojshme për përfundimin e tij. Në fund të këtij procesi, Ortaku i Vetëm do të shqyrtojë bilancin përfundimtar dhe dokumentet e tjera të likuidimit dhe do të miratojë përfundimin e procedurës së likuidimit.</p>
<p style="text-align: center;">Article 19 Changes to the Articles of Association</p> <p>19.1 The provisions of these Articles of Association can be modified by the Sole Shareholder in compliance with the provisions of the Company Law.</p>	<p style="text-align: center;">Neni 19 Ndryshimet e Statutit</p> <p>19.1 Dispozitat e këtij Statuti mund të ndryshohen nga Ortaku i Vetëm në përputhje me dispozitat e Ligjit për Shoqëritë Tregtare.</p>


Article 20
Final provisions

20.1. These Articles of Association are prepared and signed in 4 (four) originals in English language and will be translated in Albanian language. In case of discrepancies between the two versions, the English language version shall prevail.

Signed on **30.09.2021** by:

SOLE SHAREHOLDER

Ewopharma AG
Represented by:



Alain Staub

President of the Board of Directors and CEO

Neni 20
Dispozita përfundimtare

20.1 Ky Statut është përgatitur dhe nënshkruar në 4 (katër) kopje origjinale në gjuhën angleze dhe do të përkthehet në gjuhën shqipe. Në rast të mospërputhjeve midis dy versioneve, do të mbizotërojë versioni në gjuhën angleze.

Nënshkruar më **30.09.2021** nga:

ORTAKU I VETËM

Ewopharma AG
Përfaqësuar nga:



Alain Staub

President i Bordit të Drejtorëve dhe CEO